



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	6671/2022
Data	27.12.2022
Datum	
Date	
Emri i titullit	
Emri	
Signature	
PRISHTINE, PRISHTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” - FAKULTETI I ARTEVE

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është thellimi i bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” -Fakulteti i Arteve, në ideimin/konceptimin, realizimin, promovimin dhe zhvillimin e Kalendarit Kulturor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me të gjitha datat përkatëse në bazë vjetore.

Kalendari Kulturor përfshinë një listë të gjerë me data të rëndësishme të akterëve kontribues, ngjarjeve të rëndësishme kulturore dhe shtetërore, data të ndërlidhura me kulturën të cilat kanë vlerë të rëndësishme për trashëgiminë kulturore shpirtërore të Kosovës.

2. PALËT

1. Qëllimi i Memorandumi të Bashkëpunimit do të përmbushet nga:

- 1.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (më tutje MKRS); dhe
- 1.2. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”- Fakulteti i Arteve (më tutje UP-FA) (në tekstin e mëtejshëm: Palët).

3. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

1. MKRS merr përsipër obligimet si në vijim:

- 1.1. Transferon te Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” - Fakulteti i Arteve mjetet financiare në vlerë prej 150,000.00 € në vit për zbatimin e qëllimit të këtij Memorandumi.
- 1.2. Mjetet financiare si në pikën 1 i transferohen nga buxheti i Departamentit të Kulturës tek kodi buxhetor përkatës i Universitetit të Prishtinës.
- 1.3. Nga mjetet financiare si në pikën 1 për secilën degë transferohen nga 50,000.00 euro të cilat do të shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve specifike të Kalendarit Kulturor të MKRS përgjatë një (1) viti.
- 1.4. Për secilin aktivitet, MKRS sigurohet që data kalendarike shënohet me promovim adekuat në kuadër të kanaleve zyrtare të MKRS dhe e mbështet Fakultetin e Arteve në çdo aspekt të promovimit të datave në nivel shtetëror.
- 1.5. Mbikqyr zbatimin e Kalendarit Kulturor dhe kërkon informacione e raporte sipas nevojës.

4. OBLIGIMET E FAKULTETIT TË ARTEVE

1. UP-FA përmes degëve të saj: dega e arteve muzikore, dega e arteve vizuele dhe dega e arteve dramatike, merr përsipër obligimet si në vijim:

- 1.1. Të përgatis aneksin me aktivitetet së paku një muaj para përfundimit të vitit kalendarik me të gjitha datat dhe specifikimet teknike artistike të realizimit të aktiviteteve të Kalendarit kulturor për vitin vijues. Aneksi mund të përditësohet gjatë vitit përkatës kalendarik sipas nevojave të Kalendarit dhe në koordinim me MKRS.
- 1.2. Merr përsipër realizimin e plotë të aktiviteteve të përfshira në aneks të MOU.
- 1.3. Merr përsipër promovimin adekuat dhe dokumentimin e secilit aktivitet në aneks.

- 1.4. Të përgatis raport vjetor të detajuar për MKRS për realizimin e secilit prej aktiviteteve.
- 1.5. Të informoj me kohë paraprakisht MKRS, publikun dhe mediat përkatëse për aktivitetet e Kalendarit Kulturor që do t'i realizojnë.

5. ZBATIMI

Palët zotohen t'i zbatojnë obligimet e tyre të përcaktuara në këtë Memorandum, në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi. Palët përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve në mbarëvajtjen e punëve, deri në momentin e realizimit të qëllimit të këtij Memorandumi.

6. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SË MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPANASHIKUARA

1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.
2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të Fuqisë Mbinatyrore Vis maior dhe rrethanave të tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

7. AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Memorandumin e Bashkëpunimit në të ardhmen, apo në një amendament të këtij Memorandumi, të nënshkruar nga palët do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë.

9. AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimit të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda viteve 2023-2025 me mundësi vazhdimi.

10. KOPJET DHE GJUHA E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

11. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Hajrulla ÇEKU

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit



Prof. dr. Hazir HAZIRI

Dekan i FA-së

Prof. dr. Qerim QERIMI

Rektor i UP-së

Nënshkruar me datë 27 / 12 /2022, në Prishtinë.